



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE



Nr. 1929 Prot.

datë 10.11 2020

N J O F T I M

Për thirrjen e mbledhjes së KOMISIONIT RREGULLATOR

Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

E nderuar Kryetare e Rregullatorit,

Të nderuar anëtarë,

Në mbështetje të shkronjës "c", të paragrafit 1 të nenit 19 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Komisioneri vë në lëvizje Komisionin Rregullator sa herë që paraqiten çështje të kompetencës së tij.

Ju vë në dijeni, se nga ana e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është përfunduar puna për përgatitjen e projektregullore "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë". Në mbështetje të shkronjës "d", paragrafi 1, të nenit 20 të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, miratimi i kësaj projektregulloreje është kompetencë e Komisionit Rregullator.

Përsa më sipër, në respekt të këtij parashikimi ligjor propozoj thirrjen e mbledhjes për shqyrtimin e këtij projektakti.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të projektregullores dhe të relacionit shoqërues.

Materialet e mbledhjes ju vihen në dispozicion nga sekretaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe mund t'i gjeni në faqen e KQZ-së në internet www.cec.org.al në rubrikën e Njoftimeve.

KOMISIONER
Ilirjan CELIBASHI

